



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

---

Numri i lëndës: 2021:284038

Datë: 07.03.2024

Numri i dokumentit: 05425352

C.nr.1310/21

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike kontestimore të paditësve K.M, N.B, A.P, H.R dhe M.B, të cilët me autorizim i përfaqësojnë avokatët F.G dhe K.F nga Prishtina, rr. ..., kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, me objekt kontesti kompensim i shpenzimeve të udhëtimit, jashtë seance me datë 07.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësve K.M, N.B, A.P, H.R dhe M.B, dhe DETYROHET e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, që:

- Paditësit K.M - në emër të shpenzimeve të udhëtimit, për periudhën kohore nga data 17.12.2018 e deri me datë 17.12.2021, në vlerë prej 70% të biletës për 600 ditë të pranisë në punë ( $600 \times 2.10 = 1,260.00$ ), t'ia paguajë shumën prej 1,260.00 euro.
- Paditëses N.B – në emër të shpenzimeve të udhëtimit, për periudhën kohore nga data 17.12.2018 deri më datë 17.12.2021, në vlerë prej 70% të biletës për 600 ditë të pranisë në punë ( $600 \times 0.70 = 420.00$ ), t'ia paguajë shumën prej 420.00 euro.
- Paditësit A.P – në emër të shpenzimeve të udhëtimit, për periudhën kohore nga data 17.12.2018 e deri më datën 17.12.2021, në vlerë prej 70% të biletës për 240 ditë të pranisë në punë ( $240 \times 0.70 = 168.00$ ), t'ia paguajë shumën prej 168.00 euro.

- Paditëses H.R - në emër të shpenzimeve të udhëtimit, për periudhën kohore nga data 17.12.2018 e deri me datë 27.07.2019, në vlerë prej 70% të biletës për 149 ditë të pranisë në punë ( $149 \times 1.40 = 104.30$ ), t'ia paguajë shumën prej 104.30 euro.
- Paditëses M.B - në emër të shpenzimeve të udhëtimit, për periudhën kohore nga data 17.12.2018 e deri me datë 17.12.2021, në vlerë prej 70% të biletës për 600 ditë të pranisë në punë ( $600 \times 0.70 = 420.00$ ), t'ia paguajë shumën prej 420.00 euro, të gjitha me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të filloi të llogaritet nga data 17.12.2021 (datë e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

### A r s y e t i m

Paditësit K.M, N.B, A.P, H.R dhe M.B, të cilët sipas autorizimit i përfaqësojnë avokatët F.G dhe K.F nga Prishtina, pranë kësaj gjykate me datë 17.12.2021, kanë paraqitur padi me të cilën kanë kërkuar kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit si dhe kompensimin mbi bazën e kualifikimit arsimor. Ndërsa me precizimin e datës 07.11.2023, kanë kërkuar që të obligohet e paditura që t'i kompensojë në emër të licencimit si dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit dhe atë për paditësin K.M, për periudhën nga data 17.12.2018 e deri me datë 17.12.2021 t'ia paguaj shumën prej 1,440.00 euro, paditëses N.B për periudhën nga data 17.12.2018 e deri me datë 17.12.2021 t'ia paguaj shumën prej 420.00 euro, paditësit A.P për periudhën nga data 17.12.2018 e deri me datë 17.12.2021 t'ia paguaj shumën prej 168.00 euro, paditëses H.R për periudhën nga data 17.12.2018 e deri me datë 27.07.2019, t'ia paguaj shumën prej 104.30 euro si dhe paditëses M.B për periudhën nga data 17.12.2018 e deri me datë 17.12.2021 t'ia paguaj shumën prej 420.00 euro, të gjitha me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga dita e parashtrimit të padisë (17.12.2021), e deri në pagesën definitive, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm. Po ashtu i ka kërkuar shpenzimet e procedurës të specifikuar si në precizim.

Të autorizuarit e palëve ndërgjyqëse kanë arritur Marrëveshjen e Ndërmjetësimit me numër Nd.nr.849/23 të datës 13.11.2023, të cilën gjykata e ka aprovuar me Aktvendimin e datës 19.11.2023. Në marrëveshjen e arritur palët janë dakorduar që e paditura t'ua kompensojë paditësve në emër të kualifikimit- licencimit, shumat e përcaktuara më gjerësisht si në marrëveshje. Andaj, pjesë e kërkesëpadisë ka mbetur vetëm kompensimi i shpenzimeve të

udhëtimit për të gjithë paditësit. Po ashtu, të autorizuarit e palëve janë pajtuar edhe për pagesën e shpenzimeve të procedurës, të specifikuara si në marrëveshjen e lartcekur.

Gjykata me aktvendimin C.nr.1310/2021 të datës 22.09.2023, e ka obliguar të paditurën që të përgjigjet në padi, të cilin aktvendim e ka pranuar me datë 27.09.2023, ndërsa përgjigjen në padi e ka paraqitur me datë 02.10.2023.

Në përgjigjen në padi e paditura ndër të tjera ka deklaruar se padia dhe kërkesëpadia e paditësve është parashkruar pasi që Kontrata Kolektive e Arsimit është nënshkruar më 18.04.2017, ndërsa paditësit e kanë paraqitur padinë në gjykatë me datë 17.12.2021, ndërsa Kontrata Kolektive e Arsimit është me efekt veprimi deri më 18.04.2020, dhe se e njëjta nuk ka efekt për asnjë kërkesë e cila lind pas kësaj date. E paditura gjithashtu ka theksuar se të njëjtës i mungon legjitimacioni pasiv për të qenë palë në këtë procedurë kontestimore, ngase e paditura nuk ka qenë pjesëmarrëse në marrëdhëniet detyimore dhe nuk ka marrë obligime për përmbushjen e këtyre detyrimeve që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit. Gjithashtu gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë si të pa bazuar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të LPK-së, për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, pasi që në mes palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura në padi dhe në përgjigjen në padi, gjykata ka gjetur se nuk ishte kontestuese se paditësit kanë themeluar marrëdhënie pune me të paditurën, fakt ky që konstatohet edhe nga kontratat e punës dhe atë për paditësin K.M kontrata numër 59/09, e datës 14.09.2020, për paditësen N.B kontrata numër 618/09, e datës 29.09.2015, për paditësin A.P kontrata numër 111/09 e datës 01.10.2016, për paditësen H.R kontrata e punës me numër 198/09 e datës 28.02.2015, si dhe për paditësen M.B kontrata e punës numër 561/09 e datës 29.09.2015. Kontestuese nuk ishte po ashtu rrethana se e paditura Komuna e Vushtrrisë nuk ka bërë kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit në punë.

Kontestuese ishte parashkrimi i kërkesës së paditësve.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se *“kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë*

*pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”, andaj duke ju referuar dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), përkatësisht nenit 245, paragrafit 1, me të cilin përcaktohet se “kreditore në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, e lidhur me nenin 35 paragrafi 5 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, ku përcaktohet se ”Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”, erdhi në përfundim se kërkesa e paditësve është e bazuar.*

Këtë gjykata e vërtetoi edhe nga provat e ofruara nga paditësit dhe atë për paditësin K.M, vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “E.H” në fshatin .., Komuna e Vushtrrisë, i datës 23.10.2023, me të cilin vërtetohet se paditësi ka punuar në këtë shkollë në periudhat e cekura si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për 600 ditë pune. Po ashtu, nga vërtetimi i lëshuar me datë 23.10.2023 nga N.P.T “B..” Mitrovicë, është vërtetuar se paditësi udhëton çdo ditë ne relacionin Vushtrri- S1.. dhe anasjelltas, ku çmimi i biletës kthyese është 1 euro, si dhe nga vërtetimi i lëshuar me datë 20.10.2023 nga N.T.P “Taxi S..”, Vushtrri, është vërtetuar se paditësi udhëton në relacionin S2..- Vushtrri dhe anasjelltas, ku çmimi i biletës kthyese është 2 euro.

Nga vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “E.H” në fshatin .., Komuna e Vushtrrisë, i datës 23.10.2023, vërtetohet se paditësja N.B ka punuar në këtë shkollë në periudhat e cekura si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për 600 ditë pune. Po ashtu, nga vërtetimi i lëshuar me datë 21.11.2022 nga N.P.T “A..” Mitrovicë, është vërtetuar se paditësja udhëton çdo ditë ne relacionin Vushtrri- S.. dhe anasjelltas, ku çmimi i biletës kthyese është 1 euro.

Nga vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “E.H” në fshatin .., Komuna e Vushtrrisë, i datës 23.10.2023, vërtetohet se paditësi A.P ka punuar në këtë shkollë në periudhat e cekura si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për 240 ditë pune. Po ashtu, nga vërtetimi i lëshuar me datë 19.10.2023 nga N.P.T “B..” Skënderaj, është vërtetuar se paditësi udhëton çdo ditë ne relacionin Vushtrri- S.. dhe anasjelltas, ku çmimi i biletës kthyese është 1 euro.

Edhe pse nga vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “E.H” në fshatin .., Komuna e Vushtrrisë, i datës 14.02.2024, vërtetohet se paditësja H.R ka punuar në këtë shkollë në periudhat nga data 17.12.2018 e deri më 17.12.2021, për 600 ditë pune, gjykata ia aprovoi kërkesën e paditëses për

149 ditë pune, nga data 17.12.2018 e deri më 27.07.2019, në shumën prej 104.30 euro, siç i ka kërkuar paditësja në precizimin e datës 07.11.2023, bazuar në nenin 2 par.1 të LPK-së, ku përcaktohet se *“Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse.”* Po ashtu, nga vërtetimi i lëshuar me datë 09.02.2024 nga N.P.T “U..” Mitrovicë, është vërtetuar se paditësja udhëton çdo ditë ne relacionin Mitrovicë- S.. dhe anasjelltas, ku çmimi i biletës kthyeje është 1 euro.

Nga vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “E.H” në fshatin .., Komuna e Vushtrrisë, i datës 23.10.2023, vërtetohet se paditësja M.B ka punuar në këtë shkollë në periudhat e cekura si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për 600 ditë pune. Po ashtu, nga vërtetimi i lëshuar me datë 23.10.2023 nga N.P.T “B..” Mitrovicë, është vërtetuar se paditësja udhëton çdo ditë ne relacionin Vushtrri- S.. dhe anasjelltas, ku çmimi i biletës kthyeje është 1 euro.

Kundërshtimin e të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditësve, gjykata e vlerësoi si të pa bazuar pasi që në Ligjin e Punës, përkatësisht në nenin 87 të tij është përcaktuar se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, ndërsa paditësit kërkesën e tyre e kanë parashtruar për periudhën nga data 17.12.2018 e deri me datë 17.12.2021, që përfshinë periudhën kur ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 18.04.2017 dhe ajo e datës 22.01.2021, ndërsa padinë e kanë paraqitur në gjykatë më 17.12.2021.

Ndërsa, sa i përket pretendimit të të paditurës se i mungon legjitimacioni pasiv për të qenë palë në këtë procedurë kontestimore, gjykata gjeti se edhe ky pretendim është i pa bazuar për arsye se konform nenit 35 par.5 të Kontratës Kolektive të Arsimit, punëdhënësi ka për obligim të paguaj shpenzimet e udhëtimit, e që në këtë rast punëdhënësi për paditësit nuk është ndonjë organ apo institucion tjetër shtetëror, por është këtu e paditura Komuna e Vushtrrisë- Drejtoria për Arsim. Andaj, gjykata në këtë rast vlerëson se e paditura e ka legjitimacionin pasiv në këtë çështje.

Gjykata, përveç kërkesës kryesore paditësve ua njohu edhe të drejtën në kamatë në lartësi prej 8% në vit, duke llogaritur nga paraqitja e padisë (17.12.2021), e deri në pagesën definitive, duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 par.2 të LMD-së dhe Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, për Kamatën, me numër 265/2020, i datës 01.12.2020.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës, edhe pse paditësit në padi i kanë kërkuar, siç u theksua edhe më lartë, palët janë dakorduar për shpenzimet në procedurë të ndërmjetësimit, andaj nuk ishin objekt i shqyrtimit të gjykatës.

Bazuar në të lartcekurat, e në kuptim të nenit 143 dhe 398 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI**

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.1310/2021, me datë 07.03.2024

Gj y q t a r i  
Jeton Zymeri

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit.